

Data 02.10.2024.

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

« Prodhim, prerje ,transport dhe stivosje materiale drusore per Bashkine Librazhd.»

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Kodi CPV , : Produkte drusore*

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4 524 834 (kater milion e peseqind e njezet e kater mije e teteqind e tridhjetë e kater ) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertes ekonomike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Xhironja mesatare vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të pakten 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-së, për të cilin duhet të paraqitet vërtetim i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq Operatorët Ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të pakten një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nënën 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

### **2.3 Përvoja e ngjashme :**

**Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

**ose**

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. e kontrates, si edhe shërbejnë për vlerësimin e ofertës teknike/ekonomike.

2.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e mëposhtme :

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me aktivitetin objekt prokurimi.**

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **Çertifikate mjedisore e tipit “B”.**

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Ne zbatim të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

**2.5.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.**

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Ne respektim te nenit 36, 37 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ ekuivalent ”.**

**Sqarim per ofertuesit** : Ne respektim dhe zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Te dhenat e meposheme jane pergatitur nga komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe hartimit te specifikimeve teknike.(bashkangjitur DST)*

**Shenim** : Ne rastet kur citohet ne specifikimet teknike termi “marke” ose “ Cilesia e pare”, ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ ekuivalente”.

*NJESIA E PROKURIMIT*